

TERMAT E REFERENCËS

Emri i projektit	“Mbështetja e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara drejt jetesës së pavarur dhe ngritja e mirëqenies së tyre” Projekt i implementuar nga HANDIKOS dhe financiar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
Lloji i angazhimit	Ofrues/e i/e shërbimit Fizioterapeutik
Lokacioni	Prishtinë
Orari i punës	Orar të plotë
Kohëzgjatja	Gusht – Dhjetor 2022
Data e pritshme e fillimit	1 Gusht 2022
Raporton tek	Menaxheri/ja i/e projektit

1. HYRJE

Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës (tani e tutje HANDIKOS), është organizatë jo-qeveritare e zhvillimit shoqëror, e themeluar në vitin 1983, duke synuar arritjen e njohjes dhe pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara (PAK) në shoqëri. HANDIKOS mbron në mënyrë aktive në nivel lokal dhe qendror të drejtat e PAK, duke synuar krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës përmes rritjes së mundësive të punësimit; përmirësimin e qasjes në edukim, mirëqenie sociale dhe skemave të mbrojtjes sociale; dhe përmirësimin e qasjes fizike.

1.1 KONTEKSTI I PROGRAMIT

HANDIKOS është duke implementuar projektin “Mbështetja e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara drejt jetesës së pavarur dhe ngritja e mirëqenies së tyre”, i cili financohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Përmes këtij projekti HANDIKOS synon të mbështesë zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe në mirëqenien e tyre dhe familjes përmes shërbimeve multidiciplinare të qëndrimit ditor dhe bashkëveprimit ndërsektorial.

Në kuadër të këtij projekti, me qëllim të avancimit të zhvillimit dhe ruajtjes së mirëqenjes; HANDIKOS është në kërkim të punësimit të një ofu=ruesi të shërbimit fizioterapeutik me orar të plotë të punës.

2. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME E POZITËS

Ofruesi i shërbimit fizioterapeutik do të jetë përgjegjës për ofrimin për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke përfshirë vlerësimin e nevojave të fëmijëve, hartimin e planeve të punës sipas qasjes multidiciplinare; realizimin e seancave individuale dhe hartimin e raporteve të punës që dëshmojnë progresin e arritur të fëmijëve. Ai/ajo do të ofrojë mbështetje fëmijëve në fushën e zhvillimit fizioterapeutik.

2.1 DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Ofrimin e shërbimit fizioterapeutik përmes seancave individuale;

- Identifikimi i përfituesve potencial të shërbimit dhe vlerësimi i nevojave të tyre;
- Përpilimi i planeve individuale sipas parimeve të qasjes multi-diciplinare;
- Hartimi i raporteve mujore të progresit dhe dorëzimi i tyre me kohë;
- Realizon sesione informuese me prindërit e fëmijëve përfitues, rreth mbështetjes së zhvillimit fizik të fëmijëve të tyre;
- Hartimi i planeve javore dhe mujore të punës dhe dorëzimi i tyre me kohë;

2.2 NJOHURITË & PËRVOJA:

- Diplomë universiteti në fushën e Fizioterapisë;
- Përvojë paraprake pune në pozita të ngjashme (e preferuar)
- Shkathësi të mira të komunikimit dhe organizimit;
- Qasje gjithëpërfshirëse ndaj aftësisë së kufizuar;
- Shkathësi të mira ndër-personale dhe punës ekipore;
- Të jetë i familjarizuar me qasjen multi-diciplinare;
- Të ketë njohuri mbi Konventën e të Drejtave të Fëmijëve; dhe atë të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Aftësi të mira në hartimin e planeve dhe raporteve të punës;
- Qasje pozitive në zgjidhjen e problemeve;
- Aftësi për të punuar nën presion të kohës dhe për t'i respektuar afatet kohore;
- Të ketë patent shoferi. kategoria B (e preferueshme)

2.3 DOKUMENTET PËR APLIKIM:

- Curriculum Vitae (CV);
- Letër e motivimit që argumenton përshtatshmërinë e kandidatit me pozitën e hapur;
- Të paktën një referencë nga punëdhënësi/bashkëpunëtorët e mëparshëm;
- Kopjen e diplomës së nivelit më të lartë të edukimit (në rast të përzgjedhjes);
- Çertifikatën që dëshmon se kandidati nuk është nën hetime (në rast të përzgjedhjes);

Kandidatët e interesuar ftohen të dorëzojnë CV-në, letrën e motivimit, kopjen e diplomës; dhe referencat në: handikos@handi-kos.org

Ju lutemi që ta cekni në titull: “Aplikim- Ofrues i shërbimit Fizioterapeutik”

Do të kontaktohen vetëm kandidatët që hyjnë në listën e ngushtë.

Afati për aplikim: 3 Qershor, 2022, deri në orën 23:59.

HANDIKOS është i përkushtuar për barazi gjinore dhe diversitet, dhe të ketë një ekip që përbëhet nga shkathësi, përvoja dhe aftësi të ndryshme. Ne e inkurajojmë aplikimin e kandidatëve me prejardhje të ndryshme, dhe nga komunitetet dhe sektorët e ndryshëm.

Për informata shtesë lidhur me HANDIKOS, shih www.handi-kos.org